

Kishat e hershme në Pskov të Ruisë në listën e objekteve të mbrojtura nga UNESCO



Kishat e lashta në Pskov të Ruisë në listën e objekteve të mbrojtura nga UNESCO

17 ndërtesa unike të qytetit Pskov, të ndodhur në veriperëndim të Ruisë, janë shtuar së fundmi në listën e objekteve të mbrojtura të kultit nga UNESCO.

Pskovi është një ndër qytetet më të lashta të Ruisë, i përmendur së pari në kronikat e shek. IX. Në periudhën e Mesjetës ishte kryeqytet mjaft i pasur i republikës së Pskovit, e cila shërbente si urë lidhëse mes Ruisë dhe Evropës.

Ndërtesat në fjalë, që gjenden në pjesën e lashtë historike të qytetit, përfshijnë kisha, katedrale, manastire, kulla vrojtimi dhe ndërtesa të tjera administrative, të cilat datojnë që nga shek. XII.

Të gjitha këto kanë qenë pjesë e shkollës arkitekturore të Pskovit, e cila për 5 shekuj me rradhë influenoi dhe arkitekturën ruse, duke kulmuar në shekujt XV dhe XVI.

Ndërtesat e futura në listën e objekteve të mbrojtura nga UNESCO përfshijnë pjesë arkitekturore si vëllime kubike, kupola, oborre dhe kambanore. Kishat dhe katedralet janë të rrethuara me gardhe, kopshte apo mure rrethues.

Shkolla arkitekturore e Pskovit pati frymëzim nga traditat bizantine të Novgorodit.

radiongjallja.org